



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:276742

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05623458

KF.nr.250/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ të paditësit “Doni Product” SHPK me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SHPK me seli Prishtinë, Soliteri Avalla P+12 , kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 11.04.2024 në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, dhe në prani të përfaqësueses të palës së paditur Blerta Gatica, me datë mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Doni Product” SHPK me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SHPK me seli Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/4981, 5395, 6135 i datës 29.10.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 09.12.2021, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/491 5395, 6135, të datës 29.10.2021 për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe rritjes së paarsyeshme të çmimit të

mallit, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e ushtruar ndaj aktvendimit të Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/491 5395, 6135, të datës 29.10.2021, të anulohet si i pabazuar aktvendimi kontestues nr. 01.3.2.2/491 5395, 6135, të datës 29.10.2021, dhe të obligohet e paditura të kthej mjetet monetare të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore t'iu kthehen ankuesit në xhirollogarinë bankare shuma e mjeteve prej 7,924.36€. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor përfaqësuesi i paditësit nuk ka prezantuar ndonjë të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt, pra ftesën e ka pranuar me dt.28.03.2024, mirëpo prezencën nuk e ka arsyetuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 22.03.2024 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë komfor legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor përfaqësuesja e të paditurës ka theksuar se mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e nxjerrë të vendimit nga Dogana e Kosovës duke theksuar se Dogana ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën 6 të vlerësimit të nenit 35 të KDA-së pasi që kemi të bëjmë me mall për të cilën sektori i vlerës (ky sektor profesional përbrenda doganës) i rifreskon në baza javore çmimet e për të cilat paditësi ka deklaruar vlera dukshëm më të ulëta se sa vlera reale e mallit kontestues të cilat çmime aplikohen njëjtë për të gjithë importuesit e pemëve dhe perimeve. Po ashtu vlen të theksohet se paditësi nuk ka prezantuar dokumente as në fazën fillestare në sistemin Asycuda e as në procedurën e rivendosjes transaksionet bankare e për të cilat dogana ka pasur të pamundur të harmonizojë transaksionet bankare me importin me të cilin është zhdoganuar malli e për të cilat paditësi e ka obligim që çdo dokumentacion të dorëzuar të harmonizojë me zhdoganimet që kanë rezultuar në ato transaksione. Andaj mbesim sipas të gjitha sqarimeve ashtu siç theksuar në arsyetimin e vendimit kontestues. Sipas padisë së paditësit nuk qëndron vlera e detyrimeve ashtu siç e ka theksuar në padi vlerën prej 7,924.36 euro por duhet të jetë vlera e kontestit 7,912.95 euro. Bazuar si në thëniet e cekura dhe në bazë të shkresave të lëndës e paditura i propozon gjykatës që të arrë aktgjykim me të cilën refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe kërkesëpadia e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.04.2024 ka administruar provat dhe atë: aktvendimit të Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/491 5395, 6135, të datës 29.10.2021, Aktgjykimi 1502/19, Ekspertizën financiare të datës 19.07.2021, Deklaratat Unike Doganore kontestuese të përmendura në vendimin e kontestues, Faturat e blerjes së mallit, Urdhërpagesat e detyrimeve importuese doganore, Urdhëresat financiare të lëshuar nga paditësi, Urdhër transferet bankare ndërkombëtare, Dokumentet mbi kalkulimin e diferencës së taksave të paguar nga paditësi, Dokumentet e transportit të mallit CMR, Deklaratat Eksportuese, Deklaratat e Transitit T1, Certifikatat fito sanitare, Ankesë e palës në Doganë 15.05.2019, Aktvendimi i Doganës i datës 20.05.2019, Dosja me të dhëna të disponueshme – Sektori i Vlerës, Procesverbali i datës 17.05.2021 dhe 08.09.2021.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë-padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at: R 7146/01.04.2019, R-6347/25.03.2019, R-6532/25.03.2019, R-6136/22.03.2019, R-662/27.03.2019, R6748/28.03.2019, R7004/30.03.2019, R6375/25.03.2019, R6594/27.03.2019, R7833/08.04.2019, R8183/11.04.2019, R8087/10.04.2019, R7405/03.04.2019, R8047/10.04.2019, R7108/01.04.2019, R8549/15.04.2019, R8658/16.04.2019, R9636/25.04.2019, R9557/25.04.2019, R-9129/20.04.2019 dhe R9162/22.04.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme në Ferizaj, me ç'rast i njëjti është proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 16.05.2019, ka ushtruar ankesa pranë Doganës së Kosovës, e për të cilat ankesa, Dogana e Kosovës fillimisht ka sjell Aktvendimet nr. nr.01.3.2.2/4981, 5395, 6135 i datës 20.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë si akte administrative përfundimtare të nxjerra në procedurën administrative në shkallë

të dytë, e të cilin aktvendim me aktgjykimet A.nr. 1502/19 të datës 08.09.2021 lënda është kthyer në rishqyrtim – rivendosje tek e paditura e cila duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi ka sjell Aktvendimin tani kontestues nr. 01.3.2.2/4981, 5395, 6135 i datës 29.10.2021, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ve:R 7146/01.04.2019,R6347/25.03.2019,R6532/25.03.2019,R6136/22.03.2019,R662/27.03.2019,R 6748/28.03.2019,R7004/30.03.2019,R6375/25.03.2019,R6594/27.03.2019,R7833/08.04.2019, R8183/11.04.2019,R8087/10.04.2019,R7405/03.04.2019,R8047/10.04.2019,R7108/01.04.2019 ,R8549/15.04.201,R8658/16.04.2019,R9636/25.04.2019,R9557/25.04.2019,R 9129/20.04.2019 dhe R9162/22.04.2019 të proceduar në Zyrën e Brendshme në Ferizaj, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 09.12.2021, ka iniciuar prapë konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura shkalla e dytë, Dogana e Kosovës duke vepruar në rigjykim sipas aktgjykimeve A.nr. 1502/19 të datës 08.09.2021, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “Doni Product” ShPK me seli në Ferizaj, këtu paditësit, për rishqyrtimin e këtij vendimi. E paditura rivlerësimin e mallit e ka bërë pasi që dokumentet përcjellëse të paditësit i ka vlerësuar si prova të pa-mjaftueshme, nisur nga fakti se subjekti nuk ka arritur të dëshmojë që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, gjithnjë duke pasur parasysh se vlerësimi i mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës dhe në rastin konkret drejtë është konstatuar gjendja faktike pasi që kemi të bëjmë me mall për të cilin Sektori i Vlerës i rifreskon në baza javore, ashtu që subjekti ka deklaruar vlera dukshëm më të ulëta se sa vlera reale e mallit kontestues të cilat çmime aplikohen njëjtë për të gjithë importuesit e pemëve dhe perimeve. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, ne vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit për shkelje esenciale të dispozitave të KDA-së, dhe atë të neneve 33 dhe 34, me arsyetimin e paditësit se zyra e pranimit qendror e Doganës së Kosovës, ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit edhe pse ka qenë dashur të aplikohet metoda e parë e vlerësimit konform nenit 33, të KDA-së, dhe vetëm në rast se nuk mund të aplikohet metoda e parë e vlerësimit atëherë neni 34, i KDA-se parasheh që metodat e vlerësimit të aplikohen sipas radhës, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, kjo pasi që nuk ka deklaruar transfer-pagesë bankare ndërkombëtare të harmonizuar në kuptim të vlerës dhe përshkrimit të numrave të faturave kontestuese, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për ta provuar vlerat e transaksioneve si të pakontestueshme, e nga i cili arsyetim, Gjykata e pranon si të drejtë konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura. Pastaj e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerat e transaksioneve të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare. Edhe pse pala paditëse ka prezantuar Gjykatës disa nga prova materiale si fatura të mallit, transfere bankare, mirëpo të njëjtit nuk kanë arrit të dëshmojnë vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar nuk është prezantuar.

Paditësi në këtë rast nga gjithsejtë 21 DUD-ave kontestues, në shkresat e lëndës ka paraqitur vetëm disa prej tyre, duke munguar edhe 8 DUD-a të tjerë kontestues, tutje paditësi ka paraqitur fatura të ndryshme me shuma dhe numër të ndryshëm, gjithashtu edhe transaksione bankare me data dhe shuma të ndryshme, mirëpo të njëjtat nuk harmonizohen me Faturat, dhe DUD-at kontestues, andaj Gjykata e ka të pamundur të harmonizoj këto transaksione bankare me importet me të cilat është zhdoganuar pasi që është obligim i subjektit që çdo dokumentacion të prezantuar të harmonizoj me zhdoganimet që kanë rezultuar bazuar në atë transaksion. Për Gjykatën arsyetimi nga Aktvendimi i Doganës së Kosovës se dokumentet nuk janë të

bashkangjitura as në sistemin Asycuda e as në procedurën e rivendosjes duke konstatuar se subjekti nuk ka arritur të dëshmoj që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit prandaj edhe vlerësimi i mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, është plotësisht i bazuar.

Si fakte vendimtare e për ta konsideruar si të ligjshëm rivlerësimin e mallit lëndor nga e paditura, për Gjykatën ka qenë mungesa e transaksioneve bankare të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe sipas përshkrimit të faturave kontestuese andaj edhe e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e 6-të, metodë kjo që gjen zbatim në neni 35, të Kodit Doganor dhe Akcizave. Gjykata vlerëson se në rastet kur nuk kemi prova të mjaftueshme apo se ato janë jo të harmonizuara nga paditësi, atëherë edhe rivlerësimi i mallit lëndor sipas të dhënave të disponueshme sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, është i pranuar dhe mbështetur në KDA, prandaj Gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore, neni 35 i KDA-së, kur është rivlerësuar malli lëndor.

Në vijim Gjykata, pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të*

përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij". Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezultoi të mos ketë dorëzuar dokumentacionin e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provojë edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*.

Duke u bazuar të lartcekurat, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102, nenit 43 para.1, dhe nenit 46, para. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.250/22, datë 11.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.